



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1098/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi, kryesues, Milena Đjerić dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Bali Osmanit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1098/2021 i datës 04.11.2021, i parashtruar nga Bali Osmanit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar të rinumërohen votat në Vendvotimin: 2101X/04R, 2102B, 2105B, 2106B/02R, 2108B/01R, 2109B, 2113B, 2114B, 2115B, 2116B, 2117B, 2118B, 2122B, 2124B/0R, 2125B, 2126B/01D, 2127B, 2128B, 2129B, 2130B, 2132B/01R, dhe 2134B.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1098/2021 (përmes postës më datë 04.11.2021), nga Bali Osmani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajit, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Skenderaj, me të cilin pretendon se në Qendrat e Votimit 2102B, 2105B, 2109B, 2113B, 2114B, 2115B, 2116B, 2117B, 2118B, 2122B, 2125B, 2127B, 2128B, 2129B, 2130B dhe në Vendvotimet, 2101X/04R, 2106B/02R, 2108B/01R, 2124B/01R, 2126B/01D, 2132B/01R, e kanë votuar, familjarë dhe miq të tij dhe kërkon nga PZAP të rinumërohen të gjitha Qendrat dhe vendvotimet e cekura në ankesë.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit të tij, kopjen e FRK-së për VV 2117B/02D si dhe një Formular të Kërkesës për Qasje në Dokumente Publike drejtuar KQZ-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen kutitë në Qendrat Votuese: 2102B, 2105B, 2109B, 2113B, 2114B, 2115B, 2116B, 2117B, 2118B, 2122B, 2125B, 2127B, 2128B, 2129B, 2130B dhe Vendvotimet: 2101X/04R, 2106B/02R, 2108B/01R, 2124B/01R, 2126B/01D, 2132B/01R, në Komunën e Skenderajit. Mirëpo, pretendimet në apel nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, nga kopja e FRK-së të një VV e bashkangjitur nga parashtruesi i apelit nuk vërteton rrethana se votuesit e pretenduar të cekur në apel nuk kanë kurrfarë teksti të deklaramit dhe se me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se sa vota i mungojnë, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave, për faktin se thëniet e apelit nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë theksuar si te tilla ne apele, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Bali Osmani, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1098/2021 më datën 09.11.2021

Kryesues i Panelit

Burim Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.